



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 684/11 Prot.

Tiranë, më 4 . 3 .2024

V E N D I M

Nr. 11, Datë 4.3.2024

P Ë R

NJË NDRYSHIM NË RREGULLOREN “PËR VEPRIMTARINË E KOMISIONIT TË  
PAVARUR TË KUALIFIKIMIT”

Në mbështetje të nenit 13, paragrafi “a” të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në zbatim të nenit 9, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të pikës 2 të nenit 35 të rregullores “Për veprimtarinë e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”, në Mbledhjen e datës 4.03.2024, Komisioni, me unanimitet,

V E N D O S I:

Në rregulloren “Për veprimtarinë e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”, miratuar me vendimin nr. 2, datë 19.07.2017 të Mbledhjes, e ndryshuar, neni 14, ndryshon dhe bëhet si vijon:

I. Në nenin 14, pas pikes 1, bëhen këto shtesa me këtë përmbajtje:

2. “Anëtari i Komisionit mund të kryejë veprimtari mësimdhënieje akademike dhe shkencore, duke përfshirë në të: shkrimin, analizën, studimin, publikimin apo dhënie leksionesh dhe kryerje trajnimesh për çështje ligjore si dhe të marrë pjesë në veprimtari që lidhen me çështje ligjore, administrimin e drejtësisë dhe çështje të tjera të lidhura me to.

3. Veprimtaritë, sipas pikës 2 të këtij neni, lejohen nëse:

- janë në përputhje me dinjitetin e ushtrimit të funksionit;
- nuk krijojnë perceptime të ndikimit ose njëanshmëri gjatë ushtrimit të funksionit;
- nuk bien ndesh me interesat thelbësorë të funksionit, duke mos cenuar afatet dhe efikasitetin në ushtrimin e funksionit.

4. Komisioneri i Komisionit, para se të fillojë veprimtarinë e paguar jashtë funksionit, duhet të njoftojë Mbledhjen e Komisionerëve, duke i paraqitur dokumentacionin që përshkruan natyrën e punës, periudhën dhe kohëzgjatjen e saj, si dhe masën e shpërblimit. Veprimtaria e lejuar jashtë funksionit, për Komisionerin e Komisionit duhet të miratohet nga Mbledhja e Komisionerëve.”

II. Reflektimin e këtij ndryshimi në rregulloren “Për veprimtarinë e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, *kpk.al*.

**K R Y E T A R**

**Roland ILIA**

